

Në bazë të nenit 19 të Ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës Nr. 2004/7, nenit 27 të Statutit të Odës Ekonomike të Kosovës, Kryetari i OEK shpallë këtë:

FTESË PUBLIKE PËR SHËRBIME PROFESIONALE PËR ZHVILLIMIN E KRITEREVE DHE STANDARDEVE TË CERTIFIKIMIT TË NDËRMARRJEVE PËR PJESMARRJE NË SISTEMIN E ARSIMIT DUAL

Oda Ekonomike e Kosovës, në kuadër të projektit “Shkathtësitë për Punësim të Qëndrueshëm në Kosovë”, financuar nga Qeveria e Luksemburgut dhe implementuar nga Agjencia për Zhvillim e Luksemburgut (LuxDev), përmes projektit “Nxitja e Inovacionit dhe Qëndrueshmërisë për Sistemin DUAL të Arsimit dhe Aftësisit Profesional në Kosovë”, bën ftesë publike për dërgimin e ofertave për ofrimin e shërbimeve profesionale për zhvillimin e kritereve dhe standardeve të certifikimit për Sistemin Dual të Arsimit dhe Aftësisit Profesional, në kuadër të Aktivitetit A1.4.1.

Shërbimet përfshijnë:

- Zhvillimet e kritereve dhe standardeve të detajuara të certifikimit;
- Hartimin e kornizës së certifikimit për kompanitë pjesëmarrëse në sistemin Dual;
- Organizimin dhe zhvillimin e sesioneve të punës;
- Organizimin e punëtorive konsultative me palët relevante të interesit;
- Mbështetje profesionale gjatë procesit të konsultimit dhe validimit të dokumenteve;
- Sigurimin e një procesi gjithëpërfshirës, teknikisht të qëndrueshëm dhe me pjesëmarrje të gjerë.

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Zhvillimi i kornizës së certifikimit	Ditë pune	18
2	Hartimi i kritereve dhe standardeve	Ditë pune	Brenda 18 ditëve
3	Punëtori konsultative dhe sesione pune	/	Brenda angazhimit
4	Dokumentimi final i certifikimit	Copë	1

Kërkesat për ofertuesin

- Përvojë të dëshmuar në Arsimin Profesional, politika arsimore/sisteme certifikimi;
- Minimum 5 vite përvojë në zhvillimin e standardeve, kornizave rregullatore ose sistemeve të akreditimit/certifikimit;
- Njohuri mbi sistemin Dual VET (përparësi);
- Aftësi profesionale në hartimin e dokumentave teknike dhe procese konsultative;
- Përvojën në bashkëpunim me institucione publike, kompani dhe palët e interesit.

Dokumentacioni i kërkuar

- CV profesionale;
- Diplomë: master në fushën e Arsimit, Ekonomi, Shkenca Sociale, ose fusha relevante;
- Letër interesi/motivuese;
- Ofertë financiare (cmimi total për 18 ditë pune, pa TVSH);
- Përshkrim Teknik të qasjes/metodologjisë;
- Minimum 2 referenca relevante ose dëshmi relevante.

Ftesa publikohet në uebfaqen zyrtare dhe në Facebook-un e Odës Ekonomike të Kosovës.

Kriteri i përzgjedhjes së ofertës fituese:

1. Propozimi teknik 70 %: Metodologjia, Kualifikimi, CV dhe përvoja, referenca
2. Propozimi Financiar 30 % **çmimi më i volitshëm i ofertuar**, duke marrë parasysh përmbushjen e kërkesave teknike dhe profesionale.

Ofruesi i shërbimit duhet ta ketë parasysh ky aktivitet do tëzbatohet deri në fund të periudhës **Mars 2026**, ndërsa cmimi total i ofertuar duhet të mbulojë të gjitha shërbimet e kërkuara për realizimin e aktivitetit A.1.4.1-Zhvillimi i Kritereve dhe Standardeve të Certifikimit, për të gjitha fazat e planifikuara deri në përfundim të projektit, pa kosto shtesë për OEK-un.

Aktiviteti synon të mbështesë zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të certifikimit për kompanitë e përfshira në systemin Dual VET, të rrisë cilësinë institucionale të procesit të certifikimit dhe të sigurojë standardizim, transparencë dhe qëndrueshmëri në zbatimin e sistemit.

Vlera totale e parashikuar: **4,500.00 EUR**.

Dokumentet duhet të dërgohen në email: arsimidual@oek-kcc.org, duke shënuar në subjekt: “Ofertë për ftesë publike – Zhvillimi i kritereve dhe standardeve të certifikimit -Dual VET”, më së largu deri më 20.02.2026, ora 14:00.

Lulzim Rafuna

Kryetar

Oda Ekonomike e Kosovës

